
THE EFFECTS OF INTERNATIONAL FINANCIAL REPORTING STANDARDS ON FINANCIAL REPORTING QUALITY

Agim Kastrati

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, akastrati7@hotmail.com

Shyqeri Kabashi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, kbiznesi@gmail.com

Abstract: This paper discusses the effects of the adoption of International Financial Reporting Standards (IFRS) on the quality of financial reporting in Kosovo. The purpose of IFRS is to develop a single set of high-quality, comprehensible and globally accepted financial reporting standards based on clearly expressed principles and legislations. The implementation of the Accounting Standards affects the quality and reliability of the financial statements. The reliability of the financial statements and their publication increases the transparency of the financial results of the economic entities. Qualitative financial reporting eliminates irregularities and reduces informality. High quality financial reporting may also contribute to improving the assessment and collection of taxes on corporate profits. Reliable financial statements affect the security of lenders and the attraction of foreign investments. In this way qualitative, transparent and reliable financial reporting has a great impact on the economic development of a country since the financial information provided by the financial statements of economic entities has a great influence on the decision making of investors, lenders and other interested parties. The adoption procedure of International Financial Reporting Standards creates challenges to the adopter and the purpose of this study was to investigate the possible challenges of adoption of this standards. There are difficulties in applying accounting standards in practice, as financial reporting standards are complex, voluminous and often changing. Implementation of these standards requires certain knowledge from professionals. The study found out that professionals in the field of financial reporting have nowhere to address their problems. Cost of adoption, training of relevant accounting professional, lack of proper instructions from regulatory bodies, were the main challenges of International Financial Reporting Standards adoption. Based on results of data collected will give conclusions and recommendations in order to facilitate the work of professionals in the field of accounting and on the other hand to enable a qualitative, transparent and comparable financial reporting.

Keywords: International Financial Reporting Standards (IFRS), Accounting Standards,

EFEKTET E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR MBI CILËSINË E RAPORTIMIT FINANCIAR

Agim Kastrati

Kolegji Biznesi Prishtinë, akastrati7@hotmail.com

Shyqeri Kabashi

Kolegji Biznesi Prishtinë, kbiznesi@gmail.com

Përmbledhje: Ky punim trajton efektet e miratimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në cilësinë e raportimit financiar në Kosovë. Qëllimi i këtyre standardeve është të zhvillojnë një grup të vetëm të standardeve të raportimit financiar me cilësi të lartë, të kuptueshme dhe të pranuar globalisht, bazuar në parime dhe legjislacione të shprehura qartë. Zbatimi i Standardeve të kontabilitetit ndikon në cilësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare. Besueshmëria e pasqyrave financiare dhe publikimi i tyre rrit transparencën e afarizmit financiar të subjekteve ekonomike. Raportimi cilësor financiar eliminon parregullsitë dhe zvogëlon informalitetin. Raportimi financiar cilësor mund të kontribuojë gjithashtu në përmirësimin e vlerësimit dhe mbledhjes së taksave mbi fitimet e korporatave. Pasqyrat e besueshme financiare ndikojnë në sigurinë e huadhënësve dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Në këtë mënyrë, raportimi financiar cilësor, transparent dhe i besueshëm ka një ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të një vendi pasi informacioni financiar i dhënë nga pasqyrat financiare të subjekteve ekonomike ka një ndikim të madh në vendimmarrjen e investitorëve, huadhënësve dhe palëve të tjera të interesuara. Procedura e miratimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar krijon sfida për adoptuesit dhe qëllimi i këtij studimi është për të hetuar problemet e mundshme të miratimit të këtyre standardeve. Në praktikë paraqiten vështirësi në raportimin financiar, pasi që standardet e raportimit financiar janë komplekse, voluminoze dhe shpesh ndryshojnë. Zbatimi i këtyre standardeve kërkon njohuri të caktuara nga profesionistët. Rezultatet e këtij punimi tregojnë se profesionistët në fushën e raportimit financiar nuk kanë ku të adresojnë problemet e tyre. Kostoja e

miratimit, trajnimi i profesionistëve përkatës të kontabilitetit, mungesa e udhëzimeve të duhura nga organet rregullatore, rrisin rrezikun për trajtimin dhe interpretimin e pasqyrave financiare dhe njëherit paraqesin sfidat kryesore të miratimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Bazuar në rezultatet e të dhënave të mbledhura do të jepen konkluzione dhe rekomandime në mënyrë që të lehtësohet puna e profesionistëve në fushën e kontabilitetit dhe nga ana tjetër do të jetë një kontribut për një raportim financiar cilësor, transparent dhe të krahasueshëm.

Fjalët kyçe: Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardet e kontabilitetit

1. HYRJE

Raportimi financiar i bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit rritë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe e bën me të lehtë dhe më efikas marrjen e vendimeve për investitorët dhe kredituesit. Historikisht, standardet e raportimit financiar janë zhvilluar individualisht nga secili shtet. Ndonjëherë standardet janë caktuar nga qeveritë, ndërsa në disa raste edhe nga profesionistët e kontabilitetit gjegjësisht, nga bordet e pavarura të kontabilitetit të shteteve përkatëse.

Me globalizimin e ekonomisë investitorët kërkojnë mundësi për investime në tërë botën. Dallimet në standardet e kontabilitetit i bëjnë pasqyrat financiare më pak të kuptueshme dhe të krahasueshme duke e dëmtuar kështu mundësinë për angazhimin efikas të kapitalit për investitorët dhe kreditorët. Kompanitë e ndryshme kërkojnë financim me çmim sa më të ulët dhe kjo vlen sidomos për ndërmarrjet e mëdha pasi që nevoja për financim dhe investim gjithmonë ekziston. Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar i sjellin përfitime ofruesve të kapitalit pasi që mundësojnë prezantimin e informatave financiare të cilat janë të kuptueshme, si brenda vendit ashtu edhe jashtë kufijve shtetëror. Këto standarde mundësojnë sigurimin e informatave financiare të cilat në janë relevante për vendimet që ofruesit e kapitalit dëshirojnë ti ndërmarrin dhe njëherit mundësojnë rritjen e krahasueshmërisë së raporteve financiare brenda shtetit si dhe jashtë tij. Në këtë mënyrë mundësohet reduktimi i kostove të të qenit në pajtueshmëri me standardet e ndryshme të kontabilitetit duke u zvogëluar kështu rreziku i informacionit për ofruesit e kapitalit, si rezultat i besimit në informacionet e pasqyrave financiare të përgatitura në bazë të SNRF-ve.

Standardizimi dhe harmonizimi në sferën e raportimit financiar në nivel global ka edhe të metat e veta kështu që disa hulumtues kanë paraqitur qëndrimet e tyre kundër harmonizimit të raportimit financiar për shkak të mos marrjes parasysh të mjedisit specifik kombëtar. Disa studiues vënë në pikëpyetje nevojën e standardeve të harmonizuara të kontabilitetit duke i trajtuar si të pa nevojshme me argumentin se për kuptimin e këtyre rregullave janë të nevojshme njohuri të hollësishme. Raportimi financiar i bazuar në standarde shihet si detyrim për vendet e pazhvilluara nga vendet e zhvilluara dhe se standardet ndërkombëtare nuk janë fleksibile dhe nuk marrin parasysh fazat e zhvillimit ekonomik dhe diferencat kulturore. Harmonizimi mund të krijoj mbingarkesë në pikëpamje të përshtatjes pasi që SNRF-të janë komplekse dhe të kushtueshme duke ndikuar në rritjen e kostos së bizneseve në lidhje me zbatimin e këtyre standardeve.

Kundërshtuesit e harmonizimit të raportimit financiar janë të pakt në numër dhe mbisundojnë mendimet e studiuesve lidhur me përparësitë që sjell raportimi financiar i harmonizuar në nivel ndërkombëtar sepse kjo mundëson krijimin e një gjuhe të përbashkët të biznesit e cila mundëson një raportim financiar transparent, të besueshëm dhe të krahasueshëm anekënd botës.

Në Kosovë deri në vitin 2011 kanë qenë në zbatim Standardet Kosovare të Kontabilitetit, ndërkaq nga ky vit të gjitha njësitë ekonomike, përpos mikrobizneseve, janë të obliguara ti aplikojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për përgatitjen e pasqyrave financiare (Ligji 04/L-014).

2. METODOLOGJIA

Me qëllim të identifikimit dhe operacionalizimit të koncepteve është përdorur metoda e incidenteve kritike, e cila ngërthen në vete një tërësi procedurash që karakterizohen me mbledhjen e të dhënave nga vëzhgimet e drejtpërdrejta të sjelljeve njerëzore. Metoda e incidenteve kritike ka për qëllim të ofrojë bazë empirike për zgjidhjen e problemeve praktike. Incident do të thotë çdo veprim i dukshëm njerëzor i përfunduar deri në atë masë që mundëson interferencën dhe parashikimin për personin që kryen atë veprim. Metoda e incidenteve kritike ka ndihmuar shumë për zhvillimin e strukturës konceptuale kur ka qenë i pamjaftueshëm bazamenti teorik për fenomene të caktuara (Walker & Truly, 1992). Përshtypjet e menaxherëve të entiteteve lidhur me efektet e aplikimit të SNRF-ve janë në masë të madhe përjetim i përvojës së tyre, prandaj edhe efektet e përshkuara mbështeten në përjetimin e brendshëm të tyre.

Përdorimi i metodës së incidenteve kritike ka shërbyer për identifikimin e temave kryesore që aktualizohen kur klientët vlerësojnë efektet e aplikimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Për mbledhjen e informacioneve të nevojshme kemi përdorë pyetëtorin e përgatitur me qëllim të marrjes së përgjigjeve relevante në lidhje me pyetjet e parashtruara. Në lidhje me këtë janë pranuar 32 pyetësor të plotësuar

nga kontabilistët dhe pronarë/menaxherë të ndërmarrjeve të cilët janë lutur të përgjigjen në një pyetje të parashtruara lidhur me efektet e aplikimit të SNRF-ve.

Metodologjia e ndjekur në këtë punim përpos burimeve parësore bazohet edhe në burime dytësore. Me anë të burimeve dytësore është bërë një studim gjithëpërfshirës në drejtim të hulumtimit dhe analizës së punimeve të shumta në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të studiuesve të fushës me qëllim evidentimin e efekteve dhe problemeve lidhur me raportimin financiar dhe zbatimin e SNRF-ve. Fokusi në këtë aspekt do të jetë edhe në përparësitë dhe të metat e zbatimit të SNRF për njësitë e vogla dhe të mesme ekonomike. Burimet dytësore kanë shërbyer për të ndërtuar kuadrin teorik.

Literatura e shkruar në këtë lëmi ka një spektër të gjerë punimesh në lidhje me subjektin e zgjedhur për studim e cila gjë e forcoi bindjen tonë edhe më tepër në përcaktimin për të vazhduar me këtë studim si dhe në përcaktimin e objektivave kyç të studimit. Për gjetjen e të dhënave dytësore që janë përdorur si pika referimi për këtë studim, kryesisht kemi shfrytëzuar internetin.

3. REZULTATET

Gjetjet e këtij punimi kanë treguar se adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në Kosovë ka qenë efektiv pasi që ka ndikuar pozitivisht në fushën e raportimit financiar. Rezultatet e këtij punimi kanë treguar se aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ndikon në ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare. Përgatitja e pasqyrave financiare bazuar në SNRF dhe publikimi i tyre ngrit transparencën e afarizmit financiar të subjekteve ekonomike. Raportimi financiar i bazuar në standarde ndërkombëtare është më cilësor dhe eliminon parregullsitë si dhe zvogëlon informalitetin. Pasqyrat financiare të besueshme ndikojnë në ngritjen e sigurisë për kredithënësit dhe investitorët. Në këtë mënyrë raportimi financiar cilësor, transparent dhe i besueshëm, ka ndikim të madh në thithjen e investimeve nga jashtë pasi që informacionet financiare që ofrohen nga pasqyrat financiare të subjekteve ekonomike kanë ndikim të madh në vendimmarrjet, si të investitorëve të ndryshëm ashtu edhe të kredithënësve dhe palëve tjera të interesuara.

Rezultatet e këtij punimi kanë treguar se SNRF-të për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NMV) janë të përshtatshme për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të rezultateve afariste dhe gjendjes financiare të njëjësive ekonomike. Kjo gjë është e arsyeshme pasi që SNRF për NVM i është përshtatur ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat nuk kanë përgjegjësi publike, përkatësisht aksionet e të cilave nuk janë të listuara në tregjet financiare. Ky standard merr parasysh edhe aftësitë e NVM-ve për të përgatitur informatat financiare dhe koston e përgatitjes së tyre. Aplikimi i SNRF për NVM rezultoi në raportim më cilësor financiar pasi që i përshtatet nevojave të këtyre ndërmarrjeve dhe nevojave të kreditorëve dhe investitorëve si dhe raportet financiare janë të krahasueshme edhe përtej kufijve të shtetit të Kosovës.

Gjetjet tona lidhur me efektet e zbatimit të SNRF janë në pajtim me studimet e mëparshme nga kjo lëmi. Shumica e shteteve të rajonit edhe më gjerë, në legjislacionet e tyre e kanë të rregulluar këtë çështje ashtu që raportimi financiar bazohet në SNRF, gjegjësisht disa shtete kanë adoptuar standardet kombëtare të kontabilitetit në pajtim me këto standarde.

Rezultatet e këtij punimi kanë treguar se përkundër përparësive të mëdha që sjell zbatimi i SNRF-ve lidhur me hartimin e raporteve financiare transparente dhe gjithëpërfshirëse, në praktikë gjatë zbatimit të këtyre standardeve paraqiten probleme të ndryshme. Vështirësitë kanë të bëjnë me atë se këto standarde janë komplekse dhe voluminoze dhe zbatimi i tyre kërkon njohuri të caktuara nga ana e profesionistëve. Njëherit kërkohet një përcjellje e vazhdueshme dhe trajnim i rregullt i stafit profesional me qëllim të mbetjes në rrjedha të këtyre standardeve për shkak të ndryshimeve të shpeshta të tyre të cilat i kërkojnë nevojat e ekonomisë globale. Rezultatet kanë treguar se vetëm njësitë e mëdha ekonomike kanë mundësi ta përballojnë koston e aplikimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të kenë staf të mjaftueshëm profesional për zbatimin e tyre. Problemi i mungesës së stafit profesional është më i theksuar te njësitë ekonomike të mesme dhe të vogla sepse ato nuk mund të përballojnë koston e kompletimit të stafit të nevojshëm profesional për zbatim të këtyre standardeve.

Gjetjet e këtij punimi tregojnë se raportimi financiar i bazuar në SNRF ofron informacione të mjaftueshme për raportim për qëllime tatimore, ashtu që raportimi financiar i bazuar në standarde mund të shërbejë si bazë e mirë për raportim financiar për qëllime tatimore.

4. DISKUTIMI

Gjetjet e këtij studimi lidhur me rritjen e cilësisë së raportimit financiar, shtimin e besueshmërisë së pasqyrave financiare, si rezultat i aplikimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë në përputhje të plotë me studimet e më parme në këtë lëmi. Pasqyrat financiare të përgatitura bazuar në aplikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar mundësojnë një raportim financiar të harmonizuar, të saktë, të besueshëm dhe të krahasueshëm e cila gjë i jep një siguri huadhënësve dhe investitorëve si dhe përdoruesve tjerë të

informacioneve që përgatiten nga profesionistët e kontabilitetit. Në sferën e adoptimit të SNRF-vë janë bërë një mori studimesh nga autorë të ndryshëm. Të arriturat e mëparshme në fushën e raportimit financiar dhe adoptimin të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar sugjerojnë se zbatimi i SNRF-ve ka dhënë efekte pozitive duke mundësuar një raportim financiar më cilësor.

Wafaa Salah* & Abdallah Abdel-Salam (2018) në një studim të tyre kanë arritur në përfundim se aplikimi i SNRF-ve ka patur efekte pozitive në cilësinë e raportimit financiar. Coelho et al. (2017) argumentuan se njohja në kohë e humbjeve të ndodhura në fitime (që bazohet në SNRF) e bëjnë raportimin financiar më informues për investitorët dhe vendimmarrësit. Capkun et al. (2016) në një studim të tyre kanë arritur në përfundim për një rritje në menaxhimin e fitimit pas miratimit ligjor të SNRF-ve. Mousa and Desoky (2014) kanë gjetur se adoptimi i SNRF-ve ka kontribuar në rritje në vlerë të bizneseve. Disa studime kanë konfirmuar që adoptimi i SNRF-ve ka rritur cilësinë e raportimit financiar (Chalmers et al. 2011, Chan et al. 2015). Raportimi financiar i bazuar në standarde të kontabilitetit ka një rol të veçantë në zhvillimin ekonomik të një vendi (Kastrati, 2019).

Në praktikë paraqiten vështirësi pasi që standardet e raportimit financiar janë komplekse, voluminoze dhe ndryshojnë shpesh (Kastrati, 2014). Zbatimi i këtyre standardeve kërkon njohuri të caktuara nga ana profesionistëve. Profesionistët në fushën e kontabilitetit në Kroaci janë ballafaquar me një varg problemesh në zbatimin e SNRF-ve, për shkak të komplikueshmërisë dhe ndryshimeve të shpeshta të tyre (Sacer & Posavec 2012).

Në disa raste, vështirësitë që paraqiten me rastin e aplikimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si që janë kostot e zbatimit dhe komplikueshmëria e këtyre standardeve, ka ndikuar që disa pronarë të bizneseve të jenë të demotivuar ashtu që kanë shprehur disa rezerva në drejtim të zbatimit të tyre. Përkundër vështirësive të ndryshme që dalin si rezultat i adoptimit të SNRF-ve, efektet pozitive nga zbatimi i tyre i inkurajon bizneset që të mos vihet asnjëherë në pikëpyetje implementimi i këtyre standardeve në praktikë.

5. PËRFUNDIM

Globalizimi i ekonomisë, perspektiva e integritit në BE dhe internacionalizimi i tregjeve të kapitalit imponojnë nevojën e raportimit financiar në bazë të SNRF-ve. Zbatimi i SNRF-ve nuk ka alternativ pasi që kjo është nevojë e ekonomisë globale dhe njëherit i përgjigjet objektivave të përafritit të legjislacionit vendor me atë të vendeve të BE. Në anën tjetër, standardizimi dhe harmonizimi i raportimit financiar rrisin mundësitë e njësive ekonomike për qasje në tregjet e kapitalit dhe të investimeve.

Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ndikon në ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së raporteve financiare. Përgatitja e pasqyrave financiare bazuar në SNRF dhe publikimi i tyre ngrit transparencën e afarizmit financiar të subjekteve ekonomike. Raportimi financiar i bazuar në standarde ndërkombëtare eliminon parregullsitë si dhe zvogëlon informalitetin dhe parregullsitë tjera. Pasqyrat financiare të besueshme ndikojnë në ngritjen e sigurisë për kredidhënësit dhe investitorët. Në këtë mënyrë raportimi financiar cilësor, transparent dhe i besueshëm, ka ndikim të madh në thithjen e investimeve nga jashtë pasi që informacionet financiare që ofrohen nga pasqyrat financiare të subjekteve ekonomike kanë ndikim të madh në vendimmarrjet, si të menaxhmentit ashtu edhe palëve tjera të interesuara.

Rezultatet e këtij punimi tregojnë se SNRF janë komplekse dhe voluminoze dhe zbatimi i tyre kërkon njohuri të caktuara nga ana profesionistëve. Për disa standarde nuk ka njohuri të mjaftueshme nga ana e profesionistëve të kësaj lëmie dhe për më tepër ata nuk kanë një adresë se ku të orientohen për të kërkuar këshilla profesionale për të gjetur zgjidhje për tejkalimin e vështirësive të tilla. Në këtë mënyrë lind nevoja e formimit të një trupe profesionale këshillëdhënëse në lëmin e kontabilitetit si dhe botimi i një reviste profesionale në fushën e kontabilitetit.

Gjetjet e këtij punimi tregojnë se raportimi financiar i bazuar në standarde ofron informacione të mjaftueshme për raportim për qëllime tatimore, prandaj lind nevoja e përafritit në mes të këtyre sistemeve të raportimit në mënyrë që profesionistët e kësaj lëmie të kursehen nga detyrimi i përpilimit të dy e më shumë seteve të pasqyrave financiare

LITERATURA

- Blechová, B. (2012). The Analysis of the Corporate Financial and Tax Accounting in the EU and their Harmonization.
- Capkun, V., Collins, D., & Jeanjean, T. (2016). The Effect of IAS/IFRS Adoption on Earnings Management (smoothing): A Closer Look at Competing Explanations. *Journal of Accounting and Public Policy*, 35(4): 352-394. DOI= <https://doi.org/10.1016/j.jaccpubpol.2016.04.002>.
- Coelho, A.C., Galdi, F.C., & Lopes, A.B. (2017). Determinants of Asymmetric Loss Recognition Timeliness in Public and Private Firms in Brazil. *Emerging Markets Review* 31: 65- 79. DOI= <https://doi.org/10.1016/j.ememar.2017.02.002>.
- Christensen, H. B., et al., (2015). Incentives or standards: What determines accounting quality changes around IFRS adoption? *European Accounting Review*, 24 (1): p. 31-61.

- Dayanandan, A., Donker, H., Ivanof, M., & Karahan, G. (2016). IFRS and Accounting Quality: Legal Origin, Regional, and Disclosure Impacts. *International Journal of Accounting and Information Management* 24(3): 296-316. DOI= <https://doi.org/10.1108/ijaim11-2015-0075>.
- De George, E. T., X. Li, and L. Shivakumar, A. (2016). review of the IFRS adoption literature. *Review of Accounting Studies*, 2016. 21 (3): p. 898-1004.
- Epstein, J.B., & Jermakowicz, (2010). *Interpretation and Application of International Financial Reporting Standards*, New Jersey: John Wiley & Sons. Inc.
- Gavana, G., Guggiola G., & Marenzi, A. (2010). Tax Impact of International Financial Reporting Standards: Evidence from a Sample of Italian Companies, Università dell'Insubria facoltà di economia.
- Gokulnaath, M., & et al, (2015). Implementation of International Financial Reporting Standards - Challenges Ahead IRJBM – (www.irjbm.org) Volume No – VIII, January – 2015, Issue – 2.
- Herath, S. K., & Alsulmi, F. H. (2017). International Financial Reporting Standards (IFRS): The Benefits, Obstacles, and Opportunities for Implementation in Saudi Arabia. *International Journal of Social Science and Business*, 2 (1): p. 1-18
- International Accounting Standards Board (IASB), (2009). *IFRS for Small and Medium-Sized Entities*, London: IASB
- Kaaya, I. (2015). The International Financial Reporting Standards (IFRS) and Value Relevance: A Review of Empirical Evidence. *Journal of Finance and Accounting* 3(3): 37-46
- Kastrati, A., etj. (2014). “Raportimi financiar dhe vështirësitë e bizneseve në Kosovë” “Globale Challenge” nr. 9. f.55-66.
- Kastrati, A. (2016). EUROPEAN ACADEMIC RESEARCH Vol. III, Issue 11/ February 2016 ISSN 2286-4822 www.euacademic.org, 10970-10981.
- Kastrati, A. (2019). “Ndikimi i raportimit financiar në zhvillimin ekonomik” - Knowledge-International Journal.Vol.36.1, f. 31-35
- Ligji 04/L-014, Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (2011),
Ligji 06/L-032, Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (2018),
- Mousa, G.A., & Desoky, A.M. (2014). The Value Relevance of International Financial Reporting Standards (IFRS): The Case of the GCC Countries. *Journal of Accounting, Finance and Economics* 4(2): 16-28.
- Peng, H., & Chen, M.H. (2014). A Comparison of the Value Relevance of IFRS with Taiwanese GAAP Accounting Information. *Journal of International Accounting Research (JIAR) Conference*, 2014. Available at https://af.polyu.edu.hk/media/7237/518_fi_nal.pdf.
- Perera, D. (2016). Adoption of international financial reporting standards (IFRS) for small and medium-sized enterprises (SMEs): problems and challenges.
- Sacer, M., & Posavec, S. R. (2012). Analiza problema praktične primjene međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja u Republici Hrvatskoj, *Ekonomski pregleđ*, 63 (9-10) 541-560
- Sumaiya, F. (2016). International Financial Reporting Standards (IFRS), research Ambition (An Multinational interdisciplinary E – Journal) Vol. 1, Issue – 2, August, 2016 Pg. 198-207 ISSN NO. 2456 0146.
- Virgil Nbellah, A., & Gayomey, J. (2016). IFRS / IAS Adoption and its Tax Challenges and Management, *The International Journal Of Business & Management* (ISSN 2321–8916), Vol 4 Issue 5 May, 2016 Pg. 197 – 210 www.theijbm.com
- Wafaa, S., & Abdel-Salam, A. (2018). “The Effects of International Financial Reporting Standards on Financial Reporting Quality”, *Athens Journal of Business and Economics*.